

V E N D I M
Nr. 271, datë 10.6. 1999

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË MJEDISEVE TË LIDHJES SË
SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, QENDRËS KULTURORE FRANCEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 901, të Kodit Civil, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në përdorim, pa shpërblim, të truallit dhe të të gjitha mjediseve të godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Qendrës Kulturore Franceze.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të kryejë procedurat e nevojshme, për të vënë në dispozicion të Qendrës Kulturore Franceze mjediset përkatëse.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko